



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 5403 prot.

Himarë, më 24.07 . 2026

Lënda: Dërgohet për miratim projektvendimi “Për miratimin e listës së rrugëve ekzistuese sipas horografive”.

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

✓
Himarë

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, *i përditësuar*, ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, *i përditësuar*, ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, *i përditësuar*, ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, *i përditësuar*, ligjin nr.111/2018 “Për kadastrën” *i përditësuar*, VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, *i ndryshuar*, VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, *i ndryshuar*, VKM nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, *i përditësuar*; si dhe referuar relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Himarë me propozim të Kryetarit të Bashkisë me qëllim evidentimin, identifikimin dhe sistemimin e rrjetit të rrugëve ekzistuese që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Himarë:

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projekt vendimin “Për miratimin e listës së rrugëve ekzistuese sipas horografive”.
- Relacion: Mbi projekt vendimin “Për miratimin e listës së rrugëve ekzistuese sipas horografive”.

KRYETARI

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 5403/prot.
4

Himarë, më 24.07.2026

PROJEKT VENDIM

Nr. 52, Datë 24.07.2026

PËR

“MIRATIMIN E LISTËS SË RRUGËVE EKZISTUESE SIPAS HOROGRAFIVE”

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, *i përditësuar*, ligjin Nr. 68/2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, *i përditësuar*, ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, *i përditësuar*, ligjin nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, *i përditësuar*, ligjin nr.111/2018 “Për kadastrën” *i përditësuar*, VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, *i ndryshuar*, VKM nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, *i ndryshuar*, VKM nr. 686, datë 22.11.2017, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, *i përditësuar*; si dhe referuar relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Himarë me propozim të Kryetarit të Bashkisë me qëllim evidentimin, identifikimin dhe sistemimin e rrjetit të rrugëve ekzistuese që ndodhen brenda territorit administrativ të Bashkisë Himarë;

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së rrugëve ekzistuese sipas horografive bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për krijimin e dokumentit administrativ referues për identifikimin, planifikimin, administrimin, mirëmbajtjen dhe inventarizimin e infrastrukturës rrugore vendore, si dhe për përdorimin e saj në proceset e planifikimit territorial dhe të investimeve publike të Bashkisë Himarë”.

3. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë dhe administrata, për përditësimin periodik, inventarizimin dhe regjistrimin e rrugëve në përputhje me ndryshimet që rezultojnë nga verifikimet në terren, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë Himarë dhe Kryetari i Bashkisë Himarë.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike, bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 55 pika 6.


KRYETARI
Vangjel Tavo



A1

EMERTIMI: RRUGA LIDHESE E IMPIANTIT GJILEKE ME RRUGEN NACIONALE

PLANIMETRIA E RRUGES



PLANVENDOSJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI I PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE HIMARË

FSHATI ZKADASTRALE	GJATËSI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TIERA TEKNIKE
GJILEKE 1739	1.1	15 M		SH. 1/2500 2026

A2

EMERTIMI:



RRUGA PËRERAS-SHKALLË

PLANIMETRIA E RRUGES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI I PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE LUKOVË

PLANVENDOSJE



FSHATI ZKADA STRALE	GJATËSI (KM)	SEKSIONI TIP TERITORIAL I PROPOZUAR	PËRSHKRIMË	TE DHËNA TE TËJERA TEKNIKE
PËRERAS 2963	2.8	5.5 M		SH. 1/2500 2026

A3


EMERTIMI:

RRUGA BORSH - ÇORRAJ


PLANIMETRIA E RRUGES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE LUKOVË



PLANVENDOSJE



FSHATI ZKADA STRALE	GJATESI (KM)	SEKSIONI TIP TER THOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TIERA TEKNIKE
BORSII ÇORRAJ	8.5	6 M		SH. 1/2500 2026

A4

EMERTIMI: RRUGA PARALELE ME PEDONALEN E DHERMIT DHE TROTUAR

PLANIMETRIA E RRUGES

PLANVENDOSJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI I PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE HIMARË




FSHATI ZAKADASTRALE	GJATESI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TIJERA TEKNIKE
DIERMI 1481	1	9 M		SH. 1/2500 2026

A5

EMERTIMI:

RRUGA KRISTO ÇAKO, QEPARO

PLANIMETRIA E RRUGES



PLANVENDOSJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI I PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE HIMARË



FSHATI ZKADASTRALE	GHATESI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TIERA TEKNIKE
QEPARO 3095	0.7	5 M		SH. 1/2500 2026


[Handwritten signatures and initials in blue ink]

A6

EMERTIMI:

RRUGA LIVADH - JAL

PLANIMETRIA E RRUGES



PLANVENDOSJE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI I PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE HIMARË

FSHATI ZAKADASTRALE	GIATESI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TIERA TEKNIKE	SH. 1/2500	2026
HIMARE VUNO	2.3	7-9 M				

[Signature]


EMERTIMI:

RRUGET PARALELE LIVADH, LOTI 1



PLANIMETRIA E RUGES

PLANVENDOSJE



FSHATI ZKADASTRALE	GJATESI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TJERA TEKNIKE
IIMARE 1952	1.5	9 M		SH. 1/2500



A8

EMERTIMI:


RRUGA PILUR - KUÇ

PLANIMETRIA E RRUGES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE HIMARË DHE HOR-VRANISHT


PLANVENDOSJE



FSHATI ZKADA STRALE	GIATESI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TJERA TEKNIKE
PILUR KUC	4	4.5-5 M		SH. 1/2500 2026




A9	EMERTIMI:	RRUGA LIDHESE ME DETIN QEPARO FUSHE
PLANIMETRIA E RRUGES		 REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA HIMARË GRUPI T'PUNES NJËSIA ADMINISTRATIVE HIMARË
PLANVENDOSJE		
FSHATI Z.KADASTRALE	QEPARO 3095	GJATESI (KM)
SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	4.5-5 M	PERSHKRIME
TE DHENA TE TJERA TEKNIKE	SH. 1/200	2026




A10 EMERTIMI:

RRUGA MILTO KALLUSHI LOTI II

PLANIMETRIA E RRUGES



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI I PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE HIMARË

PLANVENDOSJE



FSHATI ZAKADASTRALE	GIATESI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TIERA TEKNIKE
HIMARË 1952	1.5	5 M		SH. 1/200 2026

[Signature]

[Signature]

[Signature]

A11

EMERTIMI:

RRUGA JORGJI BOLLANO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI I PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE HIMARË

PLANIMETRIA E RRUGES




GJI BOLLANO-SHEN MARINA

PLANVENDOSJE



FSHATI Z.KADASTRALE	GJATESI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR / PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TJERA TEKNIKE	SH. 1/200	2026
HIMARË 1952	0.9	5 - 7 M				

A12	EMERTIMI:	RRUGA QAZIL PAL-PLAZH, PERGJATE LUMIT				
	PLANIMETRIA E RRUGES					
		REPUBLICA E SHQIPËRISE BASHKIA HIMARË GRUPI I PUNËS NJËSIA ADMINISTRATIVE LUKOVË				
PLANVENDOSJE						
						
FSHATI Z.KADASTRALE	GJATESI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TIJERA TEKNIKE	SH. 1/200	2026
BORSII 3089	2.5	5 M				





A13 EMERTIMI:

RRUGA LIDHESË GJILEKË

PLANIMETRIA E RRUGES

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI I PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE HIMARË

PLANVENDOSJE



FSHATI Z.KADASTRALE	GUATESI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TJERA TEKNIKE
GJILEKE 1739	0.4	5.5 M		SH. 1/2500 2026





PLANIMETRIA E RRUGES

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
GRUPI I PUNËS
NJËSIA ADMINISTRATIVE HIMARË

RRUGA HYRESE PALASE



PLANVENDOSJE



ESHATI Z.KADASTRALE	GJATESI (KM)	SEKSIONI TIP TERTHOR I PROPOZUAR	PERSHKRIME	TE DHENA TE TJERA TEKNIKE	SH. 1/2500
PALASE 2863	0.3	5 M			2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Nr. 5403/2 prot.

Himarë, më 24.07 . 2026

RELACION:

**MBI PROJEKT VENDIMIN “ PËR MIRATIMIN E LISTËS SË RRUGËVE
EKZISTUESE SIPAS HOROGRAFIVE”**

Të nderuar Këshilltarë!

Projekt-Vendimi që po ju paraqesim vjen si rezultat i nevojës së Bashkisë Himarë për të krijuar dhe formalizuar një listë të unifikuar të rrugëve ekzistuese brenda territorit administrativ të saj.

Lista e rrugëve, e paraqitur në Shtojcën “**Horografi e rrugëve**”, është hartuar mbi bazën e dokumentacionit teknik ekzistues, të dhënave hartografike dhe verifikimeve të kryera në terren nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë. Ky dokument synon të shërbejë si bazë referuese zyrtare për identifikimin, administrimin, planifikimin, mirëmbajtjen, inventarizimin dhe regjistrimin e rrjetit rrugor ekzistues, në funksion të administrimit të aseteve publike dhe zhvillimit të territorit.

I. Baza Ligjore

Ky relacion mbështetet në kuadrin e legjislacionit në fuqi, përkatësisht:

- Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve të njësive të qeverisjes vendore”;
- VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar;
- VKM nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar;
- VKM nr. 686, datë 22.11.2017, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", i përditësuar;
- Si dhe aktet nënligjore dhe udhëzimet e institucioneve përgjegjëse për administrimin e rrjetit rrugor dhe të aseteve publike.

II. Qëllimi i projekt-vendimit

Projekt-vendimi synon të miratojë listën e rrugëve ekzistuese të Bashkisë Himarë, të shprehur në Shtojcën “Horografi e rrugëve”, si dokument zyrtar referues për administrimin e infrastrukturës rrugore.

Ky miratim përfshin:

- formalizimin administrativ të listës së rrugëve ekzistuese të Bashkisë Himarë;
- përdorimin e saj si bazë për planifikimin, mirëmbajtjen dhe investimet në infrastrukturën rrugore;
- evidentimin e rrjetit rrugor sipas dokumentacionit teknik dhe verifikimeve në terren;
- krijimin e një baze të dhënash të unifikuar për administrimin dhe inventarizimin e rrugëve.

III. Përshkrimi i propozimit

Propozimi konsiston në miratimin nga Këshilli Bashkiak të listës së rrugëve ekzistuese të Bashkisë Himarë, të paraqitur në Shtojcën “**Horografi e rrugëve**”, e cila përmban identifikimin administrativ të rrjetit rrugor ekzistues.

Dokumenti shoqërohet me elementët identifikues të nevojshëm për administrim, sipas formatit të hartuar nga Bashkia, si:

- emërtimi i rrugës;
- segmenti rrugor;
- vendndodhja;
- referencat territoriale sipas sistemit të përdorur.

Lista është hartuar mbi bazën e dokumentacionit ekzistues, të dhënave hartografike dhe verifikimeve në terren dhe nuk krijon apo ndryshon statusin juridik të pasurive, por shërben për evidentimin dhe formalizimin administrativ të rrjetit rrugor ekzistues.

IV. Argumentimi dhe përfitimet

Miratimi i këtij projekt-vendimi përmbush disa objektiva të rëndësishëm për Bashkinë Himarë:

- krijon një dokument zyrtar dhe të unifikuar për administrimin e rrjetit rrugor ekzistues;
- përmirëson planifikimin e investimeve dhe të mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore;
- lehtëson proceset e inventarizimit, regjistrimit dhe administrimit të aseteve publike;
- përmirëson koordinimin ndërinstitutional për shërbimet publike, sinjalistikën, emergjencat dhe planifikimin territorial;
- siguron një bazë të dhënash të përditësueshme për përdorim në programet e zhvillimit dhe planifikimit të Bashkisë.

Lista dhe horografia përkatëse do të përditësohen periodikisht nga strukturat përgjegjëse të Bashkisë, në përputhje me ndryshimet që rezultojnë nga verifikimet në terren, inventarizimi, dokumentacioni teknik dhe regjistrimet administrative, duke garantuar që dokumenti të mbetet i saktë dhe funksional si database institucionale.

V. Përfundime dhe propozim

Duke u bazuar në nevojën për konsolidimin dhe administrimin e të dhënave mbi rrjetin rrugor ekzistues, dokumentacionin teknik në dispozicion, verifikimet në terren dhe kuadrin ligjor në fuqi, Bashkia Himarë propozon miratimin e listës së rrugëve ekzistuese të Bashkisë Himarë, të shprehur në Shtojcën “**Horografi e rrugëve**”, si pjesë përbërëse e projekt-vendimit.

Ky miratim krijon bazën administrative për administrimin, inventarizimin dhe planifikimin e infrastrukturës rrugore vendore, pa ndryshuar statusin juridik të pasurive, dhe do të shërbejë si dokument referues për përfitësimet e mëtejshme, planifikimin e investimeve, mirëmbajtjen dhe proceset institucionale që lidhen me administrimin e rrjetit rrugor.

Këshilli Bashkiak i Himarës është i ftuar të shqyrtojë dhe të miratojë këtë projekt-vendim, me qëllim krijimin e një dokumenti zyrtar dhe të unifikuar për administrimin, planifikimin dhe zhvillimin e rrjetit rrugor ekzistues të Bashkisë Himarë.

GRUPI PUNËS:

Klodi Ajazaj (**Drejtör**) Elvira Marko (**Përgjegjës**) Anida Xhani (**Specialist**) Igli Çuka (**Specialist**)

